



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE SHKODËR

NOTER VASIL MARTINI  
ADRESA Rr. Luigj Gurakuqi, Nr 2,  
Lezhe  
TEL: 0682049692

## KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 6133

Nr. koleksioni: 3478

Lezhe më 15/12/2021

Ligjet referuar:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për rregullimin e të drejtave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 130, datë 20/12/2018 "Për Nënshkrimin"

\*Akti material përshkruar nga 2 fletë



A2021043370365713322



A2021043370365713322

### KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 15.12.2021 para meje Noter VASIL Gj. MARTINI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Lezhe, Rr. Luigj Gurakuqi, Nr 2, Lezhe, u paraqit personalisht:

#### PALA DHURUESE

**1-Vera Deda**, atësia Gjok, amësia Katrinë, shtetase Shqiptare, lindur në Lezhë dhe banuese në LEZHË, me adresë Fran Ivanaj 03140020; Nd. 32; H. 1; Ap. 21; Shëngjin; 4503; Lezhë, lindur më 22/03/1983, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034562115 dhe nr. personal 1353220385. (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhuruesi**")

#### PRANUESI I DHURIMIT:

**1-Ardian Nikulaj**, atësia Luigj, amësia Prenë, shtetas Shqiptar, lindur në Lezhë dhe banues në Ballëre Nd. 001; Ballëren; 4504; Lezhë, lindur më 31/10/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034749907 dhe nr. personal H210310160, (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfutuesi i dhurimit**")

**Dhuruesja e Pranuesi i Dhurimit**, pasi kanë biseduar mes tyre, në përputhje të plote me vullnetin e tyre të lire dhe të mbështetur në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në ligjin me Nr. 9901, datë 14.04.2008, rane dakort e faktikisht nënshkruan kontratën e DHURIMIT në përputhje me parimet e meposhtme;

#### KREU 1

##### OBJEKTI I KONTRATES DHE BAZA LIGJORE

- 1.1. Shoqëria "CORAL SHENGJINI" Shpk është e regjistruar si person juridik me datë 30.06.2016 të QKB. Kjo shoqëri është e regjistruar në administratën tatimore dhe disponon NIPT L68330501A. Dhuruesi Vera Deda është pronare zoterues i 100% të kuotave të kapitalit themeltar të kesaj shoqërie.
- 1.2. Objekti i kontrates është dhurimi tek Z. Ardian Nikulaj, i një kuote me 50% të kuotave të kapitalit themeltar, që dhuruesja Vera Deda zoteron në shoqërinë "CORAL SHENGJINI" shpk.
- 1.3. Ortaku i vetëm i shoqërisë "CORAL SHENGJINI" shpk, me vendimin e tij me Nr. 01, datë 15.12.2021, ka vendosur; Te miratoje transferimin e një kuote ose të 50% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk që zotërohen nga ortakja Vera Deda tek pranuesi i dhurimit Ardian Nikulaj.
- 1.4. Baza ligjore për rregullimin e marrëdhënieve mes paleve nënshkruese të kesaj kontrate janë statuti i shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk, dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligji me Nr. 9901, datë 14.04.2008. Përsa nuk gjen rregullim në lidhje me sa

Fq. 1



A2021043370365713322

siper kjo kontrate i referohet dispozitave të legjislacionit shqiptar në përputhje.

#### KREU 2

##### TE DREJTA DHE DETYRIME TE PALEVE

- 2.1. Dhuruesi i ka shpjeguar pranueses se dhurimit gjendjen juridike dhe financiare të shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk, e ka njohur atë me të gjithë dokumentacionin e shoqërisë si dhe me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë persiper.
- 2.2. Pasi është njohur me gjendjen juridike dhe financiare të shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk, me të gjithë dokumentacionin e shoqërisë si dhe me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë persiper, pranuesi i dhurimit është dakort të pranonte dhurimin e një kuote me 50% të kuotave të shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk në përputhje me dispozitat e kesaj kontrate.
- 2.3. Dhuruesi e siguron Pranuesin e Dhurimit se pjesët e kapitalit themeltar, objekt i kesaj kontrate janë të lira nga çdo pretendim apo e drejtë e personave të tretë dhe është përgjegjës për çdo të metë të pronës mbi keto pjesë të kapitalit themeltar që ekziston në çastin e kallimit të pronësise.
- 2.4. Dhuruesi merr persiper që me shpenzimet e tij të zgjidhe çdo mosmarrveshje që mund të lind në të ardhmen mes shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk dhe nga personave të tretë për fakte që lidhen me të drejtat mbi kuotat objekt kontrate për periudhën deri në nënshkrimin e kesaj kontrate.

#### KREU 3

##### DISPOZITA PERFUNDIMTARE DHE TE FUNDIT

- 4.1. Me nënshkrimin e kesaj kontrate dhuruesja Vera Deda do të ketë një kuote me 50% të kuotave të kapitalit të kesaj shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk, objekt kontrate dhe pas ketyre ndryshimeve, kapitali themeltar i shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk zotërohet 1 kuote nga Ortakja Vera Deda me 50% të kuotave dhe nga pranuesi i dhurimit Ardian Nikulaj me 1 kuote me 50% të kuotave të kapitalit nëpërmjet dhurimit të kuotave të shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk, pranuesi i dhurimit deklaron se i pranonte të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kjo shoqëri disponon në datën e nënshkrimit të kontrates.
- 4.2. Pjesë perberese të kesaj kontrate janë aktet e shoqërisë "CORAL SHENGJINI" Shpk, vendimi me Nr. 01, datë 15.12.2021 i ortakut të vetëm të shoqërisë "CORAL SHENGJINI" shpk.
- 4.3. Çdo mosmarrveshje mes tyre palet angazhohen se do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e konflikteve të mundshme do të jete gjykata e rrethit gjyqësor Lezhe.

Kjo kontrate është hartuar në kompjuter, pa korrigjime, në gjuhën shqipe, në përputhje të plote me vullnetin e lire të paleve, në kater kopje të barasvlefshme. Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit marrin nga një kopje, një kopje mbetet në zyrën e noterit dhe kopja

Fq. 2



A2021043370365713322

tjetër do të depozitohet në QKB.

Kontrata u lexua nga unë Noteri me ze të lartë dhe të qartë, iu shpjeguan paleve dispozitat e saj dhe pasi palet pasi konfirmuan se kontrata është e perpiluar në përputhje të plote me vullnetin e tyre të lire e nënshkruan atë pa vërejtje në praninë time. Une noterit vertetëtoji vullnetin e paleve dhe kontratën sipas ligjit.

#### P A L E T

DHURUESI  
Vera Deda

PRANUESI I DHURIMIT  
Ardian Nikulaj

NOTER  
Vasil Gj. MARTINI